



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.11.2023, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit (për periudhën 6 – 24 nëntor 2023).
2. Miratimi i procesverbaleve të datave 04, 18 dhe 31 tetor 2023.
3. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri”.
4. Miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.
5. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.
6. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar.
7. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër, hua për politikat e zhvillimit””.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Jurgys Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Toni Gogu, Damian Gjijnuri, Gazmend Bardhi, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Lavdrim Krrashi, Eduard Ndreca, Elda Hoti, Dhurata

Cupi, Greta Bardeli, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, dhe Arkend Balla.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Fatmir Mediu, Dhurata Cupi, Greta Bardeli, Bledion Nallbati, Saimir Korreshi, Fatmir Xhafaj Pandeli Majko, Erisa Xhixho, Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, Ermonela Felaj dhe Gerta Duraku.

**Të ftuar:**

Ervin Mete – ministër i Financave dhe Ekonomisë,

Mimoza Dhëmbi – drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Etugert Llazi - drejtor i Menaxhimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Fran Brahimi - drejtor i Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vasilika Vjero - zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Zarina Taja – drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Harmonizimit Fiskal të Legjislacionit për Tatimet Direkte dhe Taksimin Ndërkombëtar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhorxhina Gjoni – specialiste në Sektorin e Politikave dhe Harmonizimit Fiskal të Tatimeve dhe Taksave Direkte në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Dritan Çekani – drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Enkelejda Muçaj- zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Erjola Muka- drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adela Xhemali – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Kesjana Halili – drejtoreshë e Përgjithshme e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica - drejtoreshë në Drejtorinë e Marrëveshjeve dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Klotilda Bushka-** Përshëndetje, kolegë!

Vijojmë mbledhjen e Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, sipas njoftimit të sotëm dhe rendit të ditës për zhvillimin e mbledhjes së Komisionit në mjediset e Kryesisë së Kuvendit. Për efekt të kushteve jo të zakonta për mbajtjen e mbledhjes në mënyrë normale, sipas vendimit të Konferencës së Kryetarëve vijojmë me zhvillimin e mbledhjes *online*. Atëherë, sipas çështjeve të rendit të ditës, sot janë këto pika për diskutim dhe miratim: miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 6 – 24 nëntor 2023; miratimi i procesverbaleve të datave 04, 18 dhe 31 tetor 2023; projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri”; miratimi i kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”; shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” dhe projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”. Ky ishte rendi i ditës.

Prania *online* përbën kuorumin e nevojshëm për vlefshmërinë e kësaj mbledhjeje. Marrin pjesë 14 anëtarë të komisionit, përkatësisht: zoti Toni Gogu, zoti Denis Deliu, zoti Klevis Xhoxhi, zonja Aurora Mara, zoti Arkend Balla, zoti Eduard Ndreca, zoti Xhemal Qefalia, zonja Olta Xhaçka, zoti Lavdrim Krrashi, zoti Arben Pëllumbi, zoti Petro Koçi, zoti Saimir Hasalla, zoti Damian Gjikhuri dhe unë, në cilësinë e kryetares.

Kuorumi i nevojshëm është i pranishëm. Mbledhja zhvillohet sipas rregullave të Rregullores së Kuvendit dhe vendimeve të organeve drejtuese të tij. Kështu që pa humbur kohë, unë ju ftoj të miratojmë si fillim kalendarin e punimeve të komisionit! A jeni dakord, kolegë? Ju lutem, ngrini dorën. Kush është kundër, të kërkojë fjalën.

Ju lutem, dilni me kamera të gjithë!

Dakord, miratohet kalendari i punimeve.

Procesverbalet e datave 4, 18 dhe 31 tetor 2023. A jeni dakord, kolegë? A është ndonjë kundër? Nuk ka kundër.

Miratohen.

Vazhdojmë me miratimin e kalendarit për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”. Pro? Dakord.

Miratohet.

Sekretaria numëron votat.

U kërkoj kolegëve që kush është kundër të ngrejë kundër për kundërshtim. Dakord.

Miratohet.

Kolegë, do të kemi një ndryshim të rendit të ditës. Duke qenë se ministri Ervin Mete ka ndenjur duke na pritur dhe për efekt të rakordimit me komisionet e tjera do të bëjmë shqyrtimin e projektligjit për buxhetin e vitit 2024 dhe projektligjin për “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar” si pika të para të rendit të ditës dhe më tej të kalojmë të dyja marrëveshjet. U kërkoj mirëkuptim edhe të ftuarve, sepse ministri duhet të shkojë edhe në komisionet e tjera dhe, ndërkohë, mbledhja jonë, për efekt të situatës së krijuar, është shtyrë. Për këtë arsye ne i kemi marrë kohë ministrit. A jeni dakord? Kundër? Nuk ka.

Atëherë, zoti Ervin Mete, ministër i Financave dhe Ekonomisë, mirë se erdhët në komision! Duke qenë se ne jemi komision për shqyrtimin edhe të projektligjit për buxhetin e vitit 2024, edhe për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar””, unë do t’jua kaloj fjalën për prezantim dhe, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, do të shprehemi nëpërmjet relatorëve dhe më pas do të ketë pyetje dhe diskutime nga kolegët.

Zoti Mete shoqërohet edhe nga stafi i tij. Unë nuk po i përmend të gjithë, por janë në ekran. Gjithashtu, prezent është zoti Nikolla Lera dhe zonja Vasilika Vjero.

Vazhdojmë me prezantimin.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Ju lutem, teknika, të hapë zërin për ministrin!

**Ervin Mete**- Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Së pari, faleminderit për mundësinë për të prezantuar projektbuxhetin, edhe pse në kushte disi të pazakonta!

Krahas një panorame të shkurtër të përgjithshme unë do të fokusohem te sektori i drejtësisë dhe pastaj te pushteti vendor, në kuadër edhe të fokusit kryesor të komisionit.

Për të nisur me një panoramë të përgjithshme, projektbuxheti 2024 vendos një nivel të ri lidhur me planifikimin e shpenzimeve publike, të cilat arrijnë në rreth 736 miliardë lekë, duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, nxitjen e punësimit dhe mbrojtjes sociale, si dhe duke vijuar në të njëjtën kohë me konsolidimin fiskal.

Të ardhurat buxhetore në raport me PBB-në për periudhën 2024-2026 parashikohet të jenë mesatarisht 27,8% e PBB-së. Kjo rritje bazohet kryesisht në përmirësimin e administrimit fiskal, duke zgjeruar bazën e tatimit me synim minimizimin e informalitetit dhe shmangies tatimore.

Projektbuxheti vijon mbështetjen për një rritje domethënëse të pagave, duke bërë të mundur që brenda vitit 2024 të realizohet objektivi i vendosur për të arritur një nivel page mesatare prej 900 eurosh në muaj. Projektbuxheti, në kuadër të rritjes së pagave, parashikon rritjen e mëtejshme për mjekët e përgjithshëm, infermierët, punonjësit e tjerë shëndetësorë, mësuesit në arsimin parauniversitar, forcave të rendit, të mbrojtjes dhe niveleve zbatuese të administratës qendrore dhe vendore. Në total, efekti i përgjithshëm në buxhet për financimin e kësaj reforme madhore sa u përket pagave kap vlerën 39 miliardë lekë. Në të njëjtën kohë financohet indeksimi i pensioneve, i cili në dy vjetët e fundit kap shifrën rreth 25 miliardë lekë, e cila është shifër permanente në buxhet edhe në vitet e ardhshme. Vijon mbështetja për mbrojtjen sociale dhe shtresat në nevojë, duke alokuar rreth 33,4% të shpenzimeve të përgjithshme publike për skemën e pensioneve, ndihmën ekonomike, pagesën e paaftësisë, pagesën e papunësisë, asistencën sociale, ish-të përndjekurit, ish-pronarët, bonusin e bebes e të tjera.

Sa u përket shpenzimeve buxhetore për sektorin e drejtësisë, konstatohet se këto shpenzime kanë njohur rritje të ndjeshme që nga nisja e reformës në drejtësi në vitin 2016. Projektbuxheti i vitit 2024 parashikon rreth 26,2 miliardë lekë për drejtësinë, ose 13,5 miliardë lekë më shumë se buxheti i vitit 2016. Pra, praktikisht, është një buxhet i dyfishuar pas fillimit të reformës në drejtësi.

Edhe krahasuar me vitin 2023, buxheti i parashikuar për sektorin e drejtësisë rritet në mënyrë të konsiderueshme, me 4,2 miliardë lekë, ose afër 40 milionë euro. Këto shifra reflektojnë mbështetjen financiare për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të reformës në drejtësi, ku përfshihen institucionet e vetingut, të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, reformimin e institucioneve të sistemit të akuzës dhe sistemit gjyqësor, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë,

Shkollës së Magjistraturës, si dhe reformimin e institucioneve të tjera të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë. Në mënyrë të vazhdueshme janë mbështetur edhe kërkesat e institucioneve të drejtësisë për rialokime fondesh, të cilat janë përdorur për optimizimin e kushteve të punës, si dhe për sistemet e teknologjisë së informacionit.

Në një vështrim më të detajuar të projektbuxhetit për këtë sektor rezulton se shpenzimet e personelit për punonjësit e sistemit të drejtësisë parashikohen të jenë 16 miliardë lekë, ose 9 miliardë lekë më shumë se në vitin 2016. Rritja e ndjeshme e fondit ndër vite reflekton jo vetëm rritjen e numrit të burimeve njerëzore, por edhe rritjen e pagave për punonjësit e këtyre institucioneve.

Për vitin 2024 shpenzimet e personelit për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë janë rritur me 3,1 miliardë lekë, krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2023. Kjo rritje i dedikohet efektit financiar të reformës së pagave të nisur në vitin 2023, fond nga i cili 1,4 miliardë lekë janë akorduar vetëm për magjistratët. Gjithashtu, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes në vitin 2024 parashikohen në masën 8 miliardë lekë, ose dy herë më shumë se në vitin 2016. Këto shpenzime kanë adresuar nevojat e të gjitha institucioneve për të siguruar realizimin optimal të veprimtarisë funksionale të tyre.

Sa u përket shpenzimeve për investime, në vitin 2024 parashikohen rreth 2,3 miliardë lekë.

Projekte të reja investimesh publike që financohen në projektbuxhetin 2024, janë: për Strukturën e Posaçme mbështeten me 550 milionë lekë prioritetet e reja infrastrukurore dhe pajisjet teknologjike, të cilat parashikohen të implementohen në vitet 2024-2025; implementimi dhe përmirësimi i sistemit të regjistrimit elektronik noterial me vlerë rreth 234 milionë lekë; investime për përmirësimin e infrastrukturës në mjekësinë ligjore dhe laboratorin e toksikologjisë; financime për përmirësimin e infrastrukturës së Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë Tiranë; rikonstruksioni i Gjykatës Kushtetuese; arkiva digjitale për Këshillin e Lartë të Prokurorisë e kështu me radhë.

Ndërkohë vijon mbështetja buxhetore për ndërtimin e institucionit për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve me 632 milionë lekë për vitin 2024.

Referuar parashikimeve buxhetore për institucionet e tjera të pavarura kushtetuese, janë bërë përpjekje që akomodohen një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të tyre, duke siguruar fillimisht financimin e plotë të reformës së pagave dhe më tej të nevojave shtesë të paraqitura

gjatë diskutimeve për projektbuxhetin dhe përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026.

Duke kaluar te buxheti i pushtetit vendor, edhe për këtë kategori ka rritje të ndjeshme. Për këtë nivel qeverisjeje për vitin 2024 janë parashikuar 71,1 miliardë lekë, me një rritje prej 10,4% në raport me buxhetin e vitit 2023. Këto shpenzime për vitin 2024 zënë afër 3% të PBB-së. Pjesë e rëndësishme e buxhetit të pushtetit vendor është granti i qeverisjes qendrore për njësitë vendore në masën 36,5 miliardë lekë, ose afër 350 milionë euro.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2024 është në masën 24,3 miliardë lekë. Përveç transfertave të pakushtëzuara dhe të ardhurave të veta, pra, shumës prej 71 miliardë lekë, në portofolin e buxhetit vendor, ku përfituese do të jenë drejtpërdrejt bashkitë, parashikohen edhe 15,3 miliardë lekë, që alokohen nga ministritë e linjës dhe institucionet qendrore. Ndër to kemi: investime për rikonstruksion/ndërtim ujësjellësish për bashkitë në vlerën 4,5 miliardë lekë; investime nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për infrastrukturën vendore dhe rajonale në vlerën 4 miliardë lekë; fondi për emergjencat civile, për bashkitë në shumën 2,5 miliardë lekë për financimin e projekteve që lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe digat; investime për rikonstruksion, ndërtim dhe rehabilitim shkollash 9-vjeçare, të mesme në vlerën 2,2 miliardë lekë; investime për ujitjen dhe kullimin, 400 milionë lekë; fondi social, në shumën 320 milionë lekë; si dhe pastrimi i bregdetit, i cili këtë vit shtrihet thuajse në të gjithë vijën bregdetare për disa bashki, i menaxhuar nga Ministria e Mjedisit, në vlerën 300 milionë lekë.

Me përfundimin e censusit do të merren parasysh të dhënat e tij edhe për të rishikuar apo rikalibruar mënyrën sesi shpërndahet transferata te bashkitë.

Këto ishin çështjet kryesore që doja të ndaja me ju për sa i përket projektbuxhetit dhe, specifikisht, fushave që mbulon komisioni.

Shumë faleminderit!

**Klotilda Bushka**- Faleminderit, zoti Ministër!

Meqenëse e keni fjalën, a mund të bëni edhe një prezantim të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”?”

**Ervin Mete** - Do të jetë zëvendësministrja, zonja Vjero, që do të flasë për taksat kombëtare.

**Klotilda Bushka** - Dakord.

Relatorët, kolegët Saimir Hasalla dhe Klevis Xhoxhi, në lidhje me projektligjin për buxhetin e vitit 2024, kush e do fjalën i pari?

Zoti Xhoxhi, fjala për ju.

Të hapet mikrofoni.

**Klevis Xhoxhi** - Faleminderit, kryetare!

Kolegë, mirëdita!

Siç e dini, sot diskutojmë projektligjin për buxhetin e shtetit. Ky është një projektligj që i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi në komision, por edhe në seancë.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Në fakt, e dëgjuam prezantimin e ministrit, që paraqiti në mënyrë të detajuar edhe shifrat, edhe objektivat që kanë ndërmarrë Ministria e Financave dhe qeveria shqiptare në këtë draft të depozituar për buxhetin e shtetit.

Duhet të kemi parasysh periudhën e vështirë, që ka kaluar ekonomia shqiptare, por edhe ajo botërore në përgjithësi gjatë vitit 2023. E theksoj se është pozitiv fakti që të paktën ekonomia shqiptare deri tani ka arritur t'i përballojë relativisht mirë të gjitha goditjet, duke arritur në fund të këtij viti, pra të vitit 2023, një rishikim të objektivit të rritjes ekonomike nga 2,6 në 3,7 %, ashtu siç e kanë rishikuar këtë rritje edhe treguesit nga Banka Botërore dhe nga FMN-ja. Janë pikërisht këto institucione financiare që kanë dhënë vlerësime shumë pozitive për ekonominë tonë si një nga ekonomitë më rezistente të rajonit, ndërkohë që edhe perspektiva ekonomike në vazhdim mbetet pozitive.

Ky projektbuxhet, që kemi nisur të shqyrtojmë, parashikon që për herë të parë të kalojnë në 7 miliardë euro shpenzimet publike të planifikuara për vitin 2024.

Për vitin 2024 parashikohet një rritje ekonomike prej 3,8% dhe një rritje mesatare vjetore prej rreth 4% për periudhën afatmesme. Rritja ekonomike do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike, që do të shkojë në 5,3% të PBB-së, duke u përqendruar në financimin e projekteve me rëndësi strategjike, që synojnë zhvillimin më tej të ekonomisë, të turizmit dhe bujqësisë.

Deficiti buxhetor për vitin 2024 planifikohet të jetë në masën 2,5% të PBB-së, nga rreth 2,2 % i pritshëm për vitin 2023. Gjithashtu, edhe borxhi publik bruto do të vazhdojë trajektoren rënëse dhe për vitin 2024 pritet të zbresë nën nivelin 60%. Kjo është për herë të parë që nga viti 2011, duke e pozicionuar vendin tonë në vendet me financa publike më të forta.



Kolegë, ministri foli me shifra për projektbuxhetin e vitit 2024 dhe unë nuk do të doja që t'i përsërisja të njëjtat shifra, pasi ju i dëgjuat, por ajo që dua të theksoj është që ky është një buxhet, të paktën për institucionet e pavarura, të cilat janë përgjegjësi e komisionit tonë, me një rritje të shpenzimeve të fondeve për këto institucione. Sidomos ky është një buxhet që shkon drejt financimit të vazhdimt të reformave.

E përmendi ministri reformën në drejtësi dhe po të shikojmë buxhetin, në vitin 2024 kemi një rritje për institucionet e drejtësisë, të cilave mendohet t'u akordohen 11,6 miliardë lekë, pra, kemi një rritje prej 20% krahasuar me vitin 2023. Po t'i shikojmë zërat, rritjen më të madhe e ka SPAK-u, KLGJ-ja dhe Prokuroria e Përgjithshme. Po ashtu, po të krahasojmë vitin 2023 me vitin 2024 kemi edhe Gjykatën Kushtetuese, Shkollën e Magjistraturës, Komisionerin Publik, ku rritja varion nga 20 deri në 30%. Gjithashtu, rritje është parashikuar edhe për të gjitha institucionet e tjera, sikundër e thashë, të cilat janë në përgjegjësi të komisioneve tona, si: Presidentit, Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisionerit të Prokurimit Publik, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Autoritetit të Dosjeve. Pra, kemi një rritje për të gjitha institucionet. Është një gjë e mirë që qeveria u jep më shumë fonde këtyre institucioneve për të çuar përpara reformën në drejtësi.

Po kështu, nuk duhet të harrojmë edhe Ministrinë e Drejtësisë, e cila edhe për vitin 2024 ka një rritje prej 1,7 miliardë lekë më shumë sesa një vit më parë. Ministria e Drejtësisë i ka të detajuara se për çfarë do t'i përdorë këto fonde dhe ato janë: ofrimi i ndihmës juridike falas për 3000 gra e vajza në nevojë; përmirësimi i kushteve në sistemin penitenciar dhe uljen e mbipopullimit të burgjeve; riintegrimi nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin e kështu me radhë.

Një reformë tjetër është ajo administrative-territoriale. Edhe qeverisja vendore vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e qeverisë, ku edhe në vitin 2024 do të kemi përsëri fonde të shtuara. Në fakt, ministri e detajoi rritjen e fondeve dhe vlerat që do të ketë pushteti vendor.

Gjithashtu, nuk mund të rri pa përmendur fondet që janë përcaktuar për buxhetin e përgjithshëm gjinor, ku objektivi i vazhdueshëm i qeverisë është i adresuar edhe në buxhetimin gjinor në sektorë të ndryshëm, pra në arsim, në shëndetësi, në mbrojtjen sociale, te rendi publik, bujqësia e të tjera.

Pak a shumë kjo është, kolegë. Pa harruar këtu që vëmendja e qeverisë është edhe ndaj në grupeve vulnerabël, ku, ashtu siç thashë, në qendër do të jenë gratë, personat në nevojë, personat me ndihmë ekonomike, pensionet e kështu me radhë.

Kolegë, në mbyllje të fjalës sime, dua t'ju kërkoj që ta votojmë në parim projektligjin. Në mbledhjet e ardhshme të komisionit do ta shqyrtojmë me detaje buxhetin, do të bëjmë dëgjesa me institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve. Dua t'ju sugjeroj të gjithëve që të japim kontributin tonë me objektivitet dhe konstruktivitet, në mënyrë që ta analizojmë siç duhet dhe të shprehemi vetëm në favor të këtij buxheti, i cili është i dukshëm një buxhet me rritje shumë ambicioze.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zoti Hasalla, a keni ndonjë gjë për të shtuar?

T'i hapet audioja zotit Hasalla.

**Saimir Hasalla** – Përshëndetje, zonja kryetare!

Në lidhje me projektligjin për buxhetin, nuk kam çfarë të shtoj më shumë, e mbështes kolegun Xhoxhi dhe i ftoj kolegët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Hasalla!

Kolegë, tani është radha për pyetje. Kush e do fjalën për pyetje, të ngrejë dorën që unë ta shikoj nga ekrani? Kolegë, a keni diskutime?

Po, zoti Hasalla.

**Saimir Hasalla** – Zonja kryetare, kam pyetje në lidhje me projektbuxhetin.

**Klotilda Bushka** – Vazhdoni me pyetjet, zoti Hasalla.

**Saimir Hasalla** – Faleminderit!

Dua ta pyes ministrin në lidhje me projektbuxhetin për bashkitë e vogla, të cilat janë në pamundësi ekonomike për të realizuar investimet për shkollat, kanalet vaditëse, mbrojtjen lumore. A janë prioritet bashkitë e vogla në këtë projektbuxhet, të cilat kanë pamundësi për të realizuar investime të natyrës më madhore sesa mundësitë që ato kanë, sidomos për investimet në shkollat 9-vjeçare, kanalet vaditëse, mbrojtjen lumore dhe investime të tjera rrugore?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Hasalla!

Zoti Ministër, keni fjalën për përgjigje.

**Ervin Mete** – Faleminderit!

Besoj se e theksova, por po e ritheksoj që buxheti vendor në tërësi rritet në mënyrë të ndjeshme me 10,4% këtë vit, në raport me vitin e kaluar, ashtu siç rritet ndjeshëm edhe granti i qeverisjes qendrore për njësitë vendore.

Duke qenë se kemi pasur rritje të nivelit të prodhimit të brendshëm bruto, pra të GDP-së, dhe ne kemi një rregull në ligjin e financave vendore të vendosur që në vitin 2017 që transferta duhet të respektojë 1% të prodhimit të brendshëm bruto, kjo kërkesë ligjore është respektuar me rigorozitet.

Në terma të transfertës do të ketë një mbështetje të shtuar për sa i përket pushtetit vendor.

Së dyti, ashtu siç e theksova, janë një sërë projektesh, të cilat i shkojnë infrastrukturës vendore apo rajonale, që ju përmendët, nëpërmjet enteve zbatuese të pushtetit qendror, ministrisë së linjës apo Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në total janë rreth 15,3 miliardë lekë, pra 145 milionë euro që u shkojnë njësive të pushtetit, vendor që lidhen me ujësjellësit, me infrastrukturën vendore, me emergjencat civile, me rehabilitimin e shkollave 9-vjeçare, investime për ujitje dhe kullim, fond social, pastrim bregdeti e kështu me radhë. Ashtu siç e thashë, në varësi edhe të rezultateve të censit ne do të rishikojmë formatin e alokimit. Sigurisht, ka një formulë se si merret parasysh popullsia, por edhe mundësia (për shkak të madhësisë) mbledhëse e njësive të pushtetit vendor, e cila më pas indeksohet dhe përkthehet në transfertë. Besoj se do të kemi një diskutim të thelluar për këtë, pasi të marrim edhe të dhënat e censit, por mesazhi është që në tërësinë e tij buxheti është shumë mbështetës për pushtetin vendor.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Hasalla, nëse keni pyetje tjetër, mund të vazhdoni.

Teknika, fjalën e ka zoti Hasalla.

**Saimir Hasalla** – Në fakt, unë e kam lexuar me imtësi të gjithë projektbuxhetin, dhe do të doja që ministri ta cilësonte edhe një herë pjesën e mbështetjes për pushtetin vendor. Në fakt, në termat makro ky është buxheti më i madh i realizuar ndonjëherë në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë gjë duhet vlerësuar qeveria. Ndaj, do të doja që kolegët e opozitës të ishin në këtë mbledhje, të bashkonin votat me ne që ta miratonin këtë projektbuxhet për realizimin e këtyre projekteve dhe reformave, sidomos të reformave në fushën e drejtësisë dhe të shumë reformave të tjera që ka nevojë shteti ynë që të ecë para për t'ua pranuar në Bashkimin Europian. Unë kam

një kërkesë të veçantë për Bashkinë e Peqinit, ndaj të gjitha këto pyetje i kam për këtë bashki. Dua nga Ministria e Financave dhe nga qeveria në përgjithësi një vëmendje më të shtuar rreth Bashkisë së Peqinit, pasi është një bashki, e cila është lënë pak pas dore nga ana e qeverisë sonë. Dua t'i kërkoj zotit ministër, por edhe qeverisë në përgjegjësi që ta kenë pak në vëmendje Bashkinë e Peqinit.

Faleminderit!

Këtë nuk e kisha pyetje, por e kisha më shumë si pyetje-diskutim.

**Klotilda Bushka** – Faleminderit!

Nuk e di nëse ndonjë koleg tjetër e do fjalën.

Me sa kuptova, zoti Hasalla kishte një konstatim dhe një kërkesë për ministrin, kështu që nuk ka nevojë për përgjigje.

Fjalën e ka zoti Petro Koçi për pyetje.

**Petro Koçi** – Zonja kryetare, a më dëgjoni, apo jo?

**Klotilda Bushka** – Po, po dëgjoheni shumë mirë, zoti Koçi.

**Petro Koçi** – Në fakt, unë nuk kam pyetje, kam një koment të shkurtër. Nuk e di nëse më lejohet tani, apo ta bëj më vonë?

**Klotilda Bushka** – Meqenëse e morët fjalën, mund të vazhdoni, zoti Koçi.

**Petro Koçi** – E dëgjova me vëmendje zotin ministër, dhe dua të përqendrohem te çështja e mbështetjes së reformës në drejtësi. Më vjen mirë që qeveria ka projektuar një mbështetje në rritje për të gjitha institucionet e reja të reformës në drejtësi. Kjo është një reformë, e cila ka dhënë shumë efekte dhe unë, pa dashur të bëj një deklaratë të veçantë, por kam bindjen time se jemi në kushtet e një republike të re që në momentin kur reforma në drejtësi ka filluar të japë efekte. Pjesa e institucioneve të drejtësisë është një arsye madhore, për të cilën personalisht do ta mbështes me të dyja duart këtë buxhet që prezanton ministri.

**Klotilda Bushka** – Zoti Koçi, përfunduat?

**Petro Koçi** – Po, po.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Koçi!

Zoti Ndreca, e kërkuat fjalën? Jo.

Cili nga kolegët e do fjalën?

Zoti Qefalia.

Ju lutem, teknika, hapjani zërin zotit Qefalia.

**Xhemal Qefalia** – A dëgjohem?

**Klotilda Bushka** – Po, zoti Qefalia, dëgjojeni.

**Xhemal Qefalia** – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër, për të gjithë informacionin!

Faleminderit relatorit për të gjithë ekspozenë që bëri për buxhetin!

Natyrisht, ne si deputetë jemi të interesuar për të gjitha ato reforma që përmendi ministri, edhe për ato që kanë të bëjnë me buxhetimin e sistemit të drejtësisë, por unë si deputet i qarkut të Tiranës dua të kem një informacion (nuk e di, ndoshta, do të diskutojmë sërish për buxhetin), zoti Ministër: a do të jetë në vëmendje të buxhetit përfundimi i Rrugës së Arbrit, si dhe një premtim tjetër, që u kemi bërë qytetarëve, përfundimi i linjës hekurudhore Tiranë – Rinas – Durrës?

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti Ministër.

**Ervin Mete** – Të dyja këto që përmendi deputeti, janë projekte që vazhdojnë të marrin mbështetje. Sot jemi në diskutimin në parim, kështu që besoj se do të kemi momente, kur të diskutohet nen për nen, të flasim si do të marrin mbështetje bashki të veçanta.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Ministër!

Cili nga kolegët e do fjalën për pyetje? Nuk ka.

Kam unë dy pyetje, zoti Ministër.

Së pari, ju në prezantimin tuaj keni përmendur që ky buxhet është më shumë se dyfishi i buxhetit që ne gjetëm kur morëm mandatet e qeverisjes sonë të njëpasnjëshëm, dhe kjo është një gjë që na bën krenarë. Ajo që të gjithë qytetarët duan të dëgjojnë sot është: a do të vijojë politika e rritjes së pagës dhe a do të përfundojë brenda vitit 2024, a buxhetohet ajo në këtë projektligj?

Së dyti, ne do të kemi rast të flasim për nevojat e institucioneve të drejtësisë dhe institucioneve kushtetuese që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve gjatë dëgjësave që ato do të kenë së bashku me përfaqësues të ministrisë suaj në këtë komision për adresimin e nevojave të tyre. Një nga dy prioritetet e rëndësishme të reformës është harta e regjyqësore, e cila ka vijuar që vitin e kaluar të buxhetohet dhe duhet të vijojë edhe në vitin 2024.

A është në politikën buxhetore të vitit 2024 krijimi i kushteve për gjykatat e reja, i mjediseve të punës, siç duhet të jenë, në vijim të vendimit të Këshillit të Ministrave për riorganizimin e rretheve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë?

Për sa u takon bashkive (nuk e di nëse ju mund ta paraqisni këtu shkurtimisht, sepse ne do t'i kemi edhe shoqatat e bashkive, edhe ministrin përgjegjës për pushtetin vendor), si është rritur performanca e tyre në menaxhimin e fondeve dhe nëse është bërë një analizë e këtyre treguesve për të vlerësuar fondet e vitit 2024? Pra, në vija të përgjithshme, sepse ne do të kemi mundësi t'i ezaurojmë gjatë diskutimit të çështjeve nen për nen dhe në dëgjesat me institucionet, por, meqenëse jemi te shqyrtimi në parim dhe këto janë çështje me prioritet në komision, duam një përgjigje tuajën në këtë moment.

Faleminderit!

Teknika, fjala është për ministrin Meta.

**Ervin Mete** – Faleminderit për pyetjet, zonja kryetare!

Do t'i marr me radhë.

Jo që nga fillimi i mandateve qeverisëse, por që nga fillimi i reformës në drejtësi, në krahasim me vitin 2016, thuajse është dyfishuar buxheti që u shkon institucioneve të drejtësisë, pra nga 13 miliardë ka shkuar në 26 miliardë. Pjesë e këtij buxheti është edhe mbështetja që u është dhënë për pagat institucioneve të drejtësisë, edhe në kuadër të reformës së pagave, dhe gjatë vitit të ardhshëm, vitit 2024, reforma e programuar në këtë fazë përfundon. Sigurisht, në të ardhmen, në vijim të dinamikave, mund të ketë vlerësime për institucione të veçanta, por ajo që ka filluar në prill të vitit 2023, si reformë e pagave, me synimin për të arritur një nivel mesatar afro 900 euro të pagës në administratën publike, planifikohet të përfundojë në fund të vitit 2024 dhe, duke filluar viti 2025, kur materializohet kostoja totale e kësaj reforme, ajo është afro 400 milionë euro. Këto 400 milionë euro nuk do të jepen vetëm në një vit, por kjo është vazhduese në të gjitha vitet, sepse paga është një nga të drejtat permanente.

Ka mbështetje sa i përket hartës së re gjyqësore. Kjo është vazhduese, është e alokuar edhe tek institucionet e drejtësisë, edhe te KLGJ-ja. Mund t'ju japim një informacion më të detajuar se si është akomoduar, edhe në kuadrin e dëgjesave me institucionet, por sigurisht që është pasur në vëmendje, përderisa është një reformë që po ndodh.

Në kuadrin e buxhetimit, duhet mbajtur parasysh që buxhetimi ndodh në disa faza, bazohet në kërkesat që vijnë nga institucionet, në prioritizimin që u japin vetë institucionet çështjeve të tyre, dhe kjo ka ardhur edhe si një kërkesë nga institucionet e drejtësisë.

Sa i përket performancës së bashkive, sigurisht që bëhet një analizë e performancës financiare, për të parë edhe se si i realizojnë bashkitë të ardhurat e tyre. Viti 2023 nuk ka rezultuar ndër vitet me performancën të mirë të bashkive. Këtu mund të kenë ndikuar zgjedhjet, dhe prandaj, me akt normativ, pati një ulje të të ardhurave të bashkive. Sigurisht që synim i vazhdueshëm është që të ketë performancë të mirë të bashkive, të ketë realizim të të ardhurave që ato duhet të mbledhin, që më pas të komplementohen nga transferta që u jep pushteti qendror. Kjo vlen edhe për komentin që bëri zoti Hasalla. Pra, në bashki të posaçme ka nevojë të përmirësohet performanca e vetë bashkive, sepse, në fund të ditës, janë pushtet vendor dhe i pavarur.

Dua të theksoj këtu se formula e ndarjes së transfertës për pushtetin vendor ka një element esencial, që quhet ekualizim. Pra, ka një element që merr në konsideratë të ardhurat, merr në konsideratë popullsinë dhe ekualizon, përpiket të amortizojë diferencat që ekzistojnë ndërmjet bashkive në pjesën e transfertës që ajo jep. E rëndësishme është që transferta, në përgjithësi, nga viti në vit është rritur me afro 13%. Kjo është një rritje domethënëse sa i përket mbështetjes që pushteti qendror i jep pushtetit vendor.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Ministër!

Në fakt, ne do të kemi mundësi t'i diskutojmë me detaje të gjitha këto çështje. Gjatë dëgjësive dhe gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, besoj se edhe relatorët, por edhe kolegët e komisionit do të jenë të vëmendshëm jo vetëm në të gjitha çështjet për të cilat ky komision është përgjegjës, sipas kompetencave që ka, por edhe duke sjellë këtu zërin e atyre që përfaqësojmë, nëpërmjet takimeve që, me sa di, të gjithë deputetët kanë bërë në zonat nga ku kanë marrë edhe titullin e përfaqësuesit, për të ngritur edhe shqetësimet e qytetarëve dhe për të kuptuar se si adresohen ato në projektligjin për buxhetin.

Kolegë, nëse nuk ka më pyetje, kalojmë në diskutime.

A ka diskutime, megjithëse disa diskutime u bënë? Nuk ka.

Kemi një buxhet me mbi 7 miliardë euro, i cili është buxheti më i madh i tranzicionit, i cili është sa dyfishi i buxhetit të 10 vjetëve më parë. Ky buxhet buxheton politikën e rritjes së pagave; nëse nuk gaboj, një e treta e buxhetit shkon për pensionet dhe për mbrojtjen sociale.

Ka një rritje të buxhetit për drejtësinë.

Ka një buxhetim të veprimtarive të pushtetit vendor nëpërmjet grantit të pakushtëzuar, i cili lidhet me analizën e performancës, por edhe të plotësimit të nevojave të tyre.

Parimet e buxhetbërjes, në kuadër të asaj që na takon si Komision i Ligjeve, janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet. Pra, ne si komision jemi përpara momentit për ta votuar në parim projektbuxhetin, sepse diskutimi dhe miratimi nen për nen dhe në tërësi do të bëhen pasi ne të kryejmë dëgjuesat me institucionet e pavarura dhe ato kushtetuese në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve.

Nëse nuk ka diskutime, u kërkoj kolegëve të dalin *online* për votimin në parim.

Teknika më thotë se të gjithë kolegët janë *online*, por duhet të dalin edhe me figurë.

Presim disa çaste, sa teknika të zgjidhë me dy kolegët pjesën e kalimit në audio dhe në video. Më thonë që ka mungesë interneti.

Olta nuk ka internet, sepse po kërkon teknikën.

Zonja Xhaçka, a është në rregull interneti?

Dakord, të nderuar kolegë, kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Kush është dakord? Ju lutem, kolegë, ngrini duart! Sekretaria të ndjekë votimin.

14 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Zoti Ministër, faleminderit! Jeni i lirë të shkoni në komisionin tjetër. Ne do t’ju kemi përsëri në komision, pasi të mbarojmë shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi.





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.11.2023, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar””.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Jurgys Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Toni Gogu, Damian Gjikhuri, Gazmend Bardhi, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Lavdrim Krrashi, Eduard Ndreca, Elda Hoti, Dhurata Cupi, Greta Bardeli, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, dhe Arkend Balla.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Fatmir Mediu, Dhurata Cupi, Greta Bardeli, Bledion Nallbati, Saimir Korreshi, Fatmir Xhafaj Pandeli Majko, Erisa Xhixho, Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, Ermonela Felaj dhe Gerta Duraku.

#### **Të ftuar:**

Vasilika Vjero – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Zarina Taja – drejtor në Drejtorinë e Politikave dhe Harmonizimit Fiskal të Legjislacionit për Tatimet Direkte dhe Taksimin Ndërkombëtar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Xhorxhina Gjoni – specialiste në Drejtorinë e Politikave dhe Harmonizimit Fiskal të  
Tatimeve dhe Taksave Direkte në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë  
Dritan Çekani – drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

**Klotilda Bushka** – Viojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar””.

Për prezantimin e këtij projektligji do t’ia jap fjalën zonjës Vasilika Vjero, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

Mirëserdhët, zonja Vjero!

Më pas do t’ua kaloj fjalën relatorëve për prezantimin e projektligjit.

Fjala për ju, zonja Vjero.

**Vasilika Vjero** – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji në fjalë parashikon rritjen sipas një kalendari 7-vjeçar të taksës së karbonit për qymyrin dhe përfshirjen në këtë taksë të disa nënprodukteve të tjera të qymyrit. Këto ndryshime përfaqësojnë hapat e nevojshëm në kuadër të hartimit të të gjithë kuadrit ligjor lidhur me angazhimin e shtetit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit, për frenimin e ndryshimeve klimaterike dhe ka të bëjë konkretisht me ligjin nr. 91 të vitit 2018 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”. Gjithashtu, do të bëjë të mundur që masa e barrës fiskale, e cila do të duhet të paguhet për çlirimin e dyoksidit të karbonit në atmosferë nga djegia e qymyrit për prodhimin e produkteve të ndryshme, si hekuri, çimentoja apo ferro-kromi, të paguhet në Republikën e Shqipërisë dhe jo në shtetin ku do të eksportohen produkti apo nënproduktet e tij. Industrinë që do të preken nga kjo masë janë industria e çimentos dhe ajo e çelikut, të cilat zënë pjesën më të madhe të përdorimit të qymyrgurit në Shqipëri si lëndë djegëse për aktivitetin e tyre.

Në për këtë propozim jemi mbështetur edhe në rregulloren nr. 2023/956 “Për vendosjen e një mekanizmi të rregullimit të kufirit të karbonit”, e miratuar nga Bashkimi Europian, e cila ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2023. Pra, Bashkimi Europian ka vendosur që të aplikojë një mekanizëm për rregullimin e kufirit të karbonit, i cili do t’i tatojë të gjitha importet drejt vendeve të Bashkimit Europian nga shtete që nuk aplikojnë apo aplikojnë një normë më të reduktuar karboni në tregun e tyre të brendshëm, krahasuar me nivelet e Bashkimit Europian.

Për rrjedhojë, duke filluar që nga viti 2026 të gjitha eksportet drejt Bashkimit Europian të industrisë e çimentos, të çelikut apo industri të tjera, të cilat kanë si lëndë të parë qymyrgurin dhe që çlirojnë karbon në natyrë gjatë procesit prodhues, do të duhet t’i nënshtrohen një detyrimi financiar të lartë për taksën e karbonit. Kjo ka si qëllim arritjen e një kufiri minimal të taksimit të

karbonit, i cili është llogaritur dhe është përcaktuar nga vlerësimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, të cilët na kanë asistuar për këtë projektligj. Ky kufi është 60 dollarë për ton/dyoksid karboni.

Vendi ynë taksën e karbonit të qymyrit e aplikon në lekë për kilogram dhe jo mbi sasinë e karbonit të çliruar në atmosferë nga ky produkt. Nëse kufirin minimal të taksimit do ta përkthejmë në lekë për kilogram, do të rezultojë se niveli minimal i taksës së karbonit mbi qymyrin duhet të jetë të paktën 15,3 lekë për kilogram qymyr nga 3 lekë për kilogram qymyr që aplikohet sot për këto industri.

Ne kemi parashikuar një kalendar 7-vjeçar për rishikimin e kësaj takse me një rritje që fillon me 0,5 lekë për kilogram në vitin 2024, vazhdon me 1,5 lekë, me 3 lekë, me 5 lekë, me 7,3 lekë dhe me 12,3 lekë shtesë, deri në një total barre fiskale që do të arrihet në vitin 2030 në shumën 15,3 lekë, nga 3 lekë që është aktualisht.

Të ardhurat që do të arkëtohen si shtesë në buxhetin e shtetit, janë në masën 170 milionë lekë. Këtu nuk bëhet fjalë për të ardhura të konsiderueshme, por për të ardhura simbolike, krahasuar me të gjithë fluksin e të ardhurave që ne marrim nga të gjitha llojet e taksave apo nga ajo që taksojmë sot, por duhet ta adaptojmë edhe me ndryshimet e reja në legjislacionin e Bashkimit European, sepse, siç e shpjeguam, edhe nëse do ta shtynim në kohë aplikimin e kësaj takse, duke filluar nga viti 2023 të gjitha kompanitë shqiptare që do të eksportojnë në Bashkimin European, do të taten atje, ndaj kemi parashikuar që tatimi të bëhet në vendin tonë dhe të mos shkojë përtej kufijve, pra në vendet e Bashkimit European.

Ky ishte prezantimi në mënyrë të përmbledhur. Megjithatë, për çdo pyetje jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Vjero!

Fjalën e ka relatori, zoti Hasalla.

**Saimir Hasalla** – Përshëndetje!

Ne jemi komision për dhënie mendimi në lidhje me projektligjin “Për taksat kombëtare”.

Ndryshimet klimaterike dhe impakti negativ i tyre mbi klimën dhe mjedisin konsiderohen nga Bashkimi European dhe Organizatat e Kombeve të Bashkuara ndër sfidat kryesore në ditët e sotme. Në këtë kuadër, këta organizma kanë hartuar politika detyruese në nivel ndërkombëtar

dhe kanë ndërmarrë angazhime për adresimin e sfidave, që lidhen me ndotjen e mjedisit dhe emetimin e gazrave në atmosferë.

Konkretisht, në përmbushje të këtyre rekomandimeve dhe të detyrimeve ndërkombëtare me fokus “mbrojtjen e klimës”, nëpërmjet propozimit të këtij projektligji synohet aplikimi i disa ndryshimeve në ligjin aktual “Për taksat kombëtare”, pra rritja e taksës së karbonit për qymyrin, si dhe përfshirjen në taksën e karbonit edhe të disa nënprodukteve dhe formave të tjera të qymyrit në terma afatgjatë. Zonja zëvendësministre i shpjegoi me detaje këto, ndaj nuk po i përsëris.

Banka Botërore, në funksion të zbatimit të politikave të tilla mbrojtëse të klimës, i ka rekomanduar vendit tonë rritjen e taksës së karbonit për qymyrin, si një nga produktet kryesore energjetike, i cili çliron dyoksid karboni në natyrë. Në kuadër të respektimit të politikave ndërkombëtare, me synim integrimin ekonomik brenda rajonit dhe në Bashkimin European diktohet marrja e masave paraprake për përafrimin e legjislacionit, në mënyrë që ngarkesa fiskale të mos jetë e menjëhershme dhe taksa mbi emetimet e karbonit për prodhimet shqiptare të shkojë në të ardhurat e buxhetit të shtetit shqiptar dhe jo të vendeve ku eksportohen produktet.

Në funksion të këtyre masave paraprake, propozohen ndryshime në ligjin në fuqi për rritjen e taksës së karbonit të qymyrit, si dhe përfshirjen në taksën e karbonit edhe të disa nënprodukteve dhe formave të tjera të qymyrit. Kjo rritje e normës tatimore e taksës së karbonit, që do të aplikohet për qymyrin, parashikohet të rritet në mënyrë graduale deri në vitin 2030.

Projektligji pritet të sjellë një efekt pozitiv në buxhetin e shtetit prej 170 milionë lekësh për vitin 2024. Ndërkohë, deri në vitin 2030 parashikohet një efekt pozitiv në buxhetin e shtetit prej 1,6 miliardë lekësh, krahasuar me vitin 2023.

Si relator i këtij projektligji, në kuadër edhe të mbështetjes së politikave ndërkombëtare për mbrojtjen e klimës, i vlerësoj parashikimet e propozuara në këtë projektligj dhe i ftoj kolegët që ta miratojnë atë në komision.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Hasalla!

Zoti Xhoxhi, a keni ndonjë gjë për të shtuar?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kolegë, bëhet fjalë vetëm për një ndryshim në thelb, pra për taksën e karbonit dhe për kategoritë si qymyri dhe të ngjashme më to.

A keni ndonjë pyetje apo diskutim? Nuk ka.

Duhet të shohim është nëse ndryshimi në këtë ligj vjen në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet dhe, sipas relatorëve, nuk ka asnjë papërputhshmëri. Pra, ne si komision vëmë re se ligji ka ardhur në përputhje me dispozitat e zbatueshme kushtetuese dhe ligjore. Nëse nuk ka pyetje apo diskutim, kalojmë në votim. Ju lutem, kolegë, duhet të dilni me figurë, në mënyrë që sekretaria të numërojë votat.

Ka një shkëputje teknike, duhet të presim një minutë teknikën.

Zoti Bardhyl është *online*.

Zoti Qefalia është *online*.

Zoti Pëllumbi, zoti Koçi, zonja Xhaçka, zoti Krrashi, zoti Balla, zoti Deliu, zoti Xhoxhi, zonja Mara, zoti Ndreca...

Ka një shkëputje interneti zoti Gjijnuri.

Ndërkohë, zoti Çyrbja po tenton të hyjë. Kolegë, duhet mirëkuptim, se mbledhjet *online* i kanë këto problematika teknike. E rëndësishme është që ne t'i japim kohën e duhur çdo procesi.

Zoti Koçi kërkon fjalën.

**Petro Koçi** – Sa të hyjnë në lidhje të gjithë kolegët, dua të them se për aprovimin e këtij projektligji mendoj se duhet të nisemi vetëm nga interesat e mjedisit dhe jo nga efektet financiare që shkakton aprovimi i këtij projektligji. Dihet që sot mjedisi është shumë problematik. Ndaj, jo pa alegori dua të them se rritja e dyoksidit po çmend edhe mendjet e politikanëve, ndaj duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për të ulur nivelin e dyoksidit në atmosferë.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Zoti Gogu ka një problem me internetin. Ai ndodhet në ambientet e Kryesisë së Kuvendit. Përpiquni të futeni nga interneti i celularit dhe jo nga ai i Kuvendit, sepse ka ngarkesë nga përdoruesit dhe shkëputet linja. Këtë më thotë teknika.

Zonja Xhaçka, a mund të dilni me figurë, ndërkohë që jeni *online*?

Kolegë, ju lutem, ngrini duart që t'ju shikojë sekretaria.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”? 14 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Kolegë, kush është dakord në tërësi me projektligjin? 14 vota pro. Kundër? Nuk ka.  
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky akt do të bëhet gati për komisionin përgjegjës.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.11.2023, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri”.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Jurgys Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Toni Gogu, Damian Gjikhuri, Gazmend Bardhi, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Lavdrim Krrashi, Eduard Ndreca, Elda Hoti, Dhurata Cupi, Greta Bardeli, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, dhe Arkend Balla.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Fatmir Mediu, Dhurata Cupi, Greta Bardeli, Bledion Nallbati, Saimir Korreshi, Fatmir Xhafaj Pandeli Majko, Erisa Xhixho, Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, Ermonela Felaj dhe Gerta Duraku.

#### **Të ftuar:**

Enkelejda Muçaj – Zëvendësministre e Infrastrukturës

Erjola Muka – Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit në Ministrinë e Infrastrukturës



**Klotilda Bushka** – Ndërkohë, do të vazhdojmë me dy pikat e fundit të rendit të ditës. Të ftuarit për këto çështje të hapin kamerat.

Vijojmë mbledhjen me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Hasalla.

Të ftuar nga Ministria e Infrastrukturës kemi zonjën Enkelejda Muçaj, zëvendësministre dhe zonjën Erjola Muka, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit

Zonja Muçaj, keni fjalën.

**Enkelejda Muçaj** – Mirëdita, zonja kryetare!

Nuk e di nëse dëgjohem?

**Klotilda Bushka** – Dëgjoheni shumë mirë, ndaj vijoni me prezantimin zonja Muçaj.

**Enkelejda Muçaj** – Faleminderit shumë për mundësinë e trajtimit të këtij akti shumë të rëndësishëm!

Ashtu siç edhe ju e relatuat, projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri. Kjo marrëveshje shërben pikërisht për t'i dhënë mundësinë Komisionit Europian që të mund të vijojë procedurat e saj të brendshme për të ndryshuar Rregulloren e BE-së nr.1315/2013 apo, siç quhet ndryshe, Rregullorja TEN-T, duke përfshirë në zgjatimin e rrjetit TEN-T kryesor europian me Korridorin 8 hekurudhor, me shtrirje në Shqipëri nga Porti i Durrësit deri në kufirin me Maqedoninë e Veriut.

Gjithë koncepti i politikës dhe ajo çka Komisioni rregullon me këtë rregullore përbën një instrument kyç për të mundësuar pikërisht zhvillimin e infrastrukturës së një transporti, i cili është koherent, efikas, multimedial apo le të themi në nivele të ndryshme të llojeve të transportit me një cilësi të lartë në të gjithë Bashkimin Europian dhe përfshin: hekurudha, rrugë ujore të brendshme, rrugë transporti detar, rrugë që lidhin nyje detare, porte detare dhe të brendshme, aeroporte dhe terminale; nxitjen e transportit efikas në vetvete të njerëzve dhe të mallrave; siguron akses në punë dhe shërbime dhe mundëson tregtinë dhe rritjen ekonomike, duke siguruar këtë herë me zgjatimin edhe përfshirjen e korridorit hekurudhor të Korridorit 8, që lidh Durrësin me Maqedoninë e Veriut.

Gjithashtu, e kthen këtë segment në rrjetin TEN-T european, duke krijuar një kohezion, një bashkëpunim dhe një qasje të koordinuar ndërmjet investimeve të Bashkimit European edhe në Shqipëri pikërisht me investimet në këta sektorë, që këtë herë janë kryesorë dhe mundësojnë përthithjen e fondeve dhe të investimeve, të cilat sigurohen nga një standard tejet të lartë në të gjithë pjesën e ndërtimit të segmentit hekurudhor.

Sigurisht, për ne dhe për Shqipërinë kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme, sepse na vendos në hartën e rrjeteve traseuropiane për rrugët, portet, aeroportet dhe në këtë rast kemi edhe segmentin hekurudhor Durrës – Maqedoni e Veriut, duke mundësuar pikërisht realizimin e një sërë objektivave të qeverisë shqiptare në fushën e transportit, objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së, pikërisht objektivi 9-të, në lidhje me zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme, planeve dhe strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe të gjelbër të BE-së dhe, gjithashtu, mobilitetin e gjelbër, duke mundësuar investime të qëndrueshme dhe me standarde të larta në një nga rrjetet, pikërisht në sistemin hekurudhor, që përbën një nga mënyrat e transportit që do të ulë ekspozimin ndaj dëmtimit të ambientit apo të gazrave apo të tjera materiale të dëmshme për mjedisin.

Të nderuar, ky akt është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, ndaj e kemi paraqitur para jush me qëllimin për t’i dhënë mundësi vijimit nga ana e Komisionit European për të ndryshuar Rregulloren e saj dhe përfshirjen e hartave, që janë anekse të kësaj marrëveshjeje, në Rregulloren përkatëse nr.1315/2013.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, jemi të hapur për çdo pyetje.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Muçaj!

Zoti Hasalla, sot keni shumë punë, fjala për ju si relator.

**Saimir Hasalla** – Faleminderit kryetare!

Projektligji që po diskutojmë tani është ratifikimi i marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Projektligji është në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Rregullores së Kuvendit, si dhe ligjit “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje të nivelit të lartë do bëhet i mundur riklasifikimi i Korridorit 8 hekurudhor, nga rrjet gjithëpërfshirës në rrjet kryesor dhe ky riklasifikim do të mundësojë sigurimin e investimeve për realizimin e këtij projekti madhor për Shqipërinë dhe për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Zonja zëvendësministre ishte shumë shteruese në shpjegimin e këtij projektligji, ndaj unë nuk do të kaloj më në përsëritje, por do të vlerësoj rëndësinë që ka kjo marrëveshje si një hap shumë pozitiv për infrastrukturën hekurudhore shqiptare, pasi do t'i japë më shumë mundësi financimi këtij korridori dhe ndërtimin e tij të plotë, sipas standardeve europiane, deri në vitin 2040. Unë i ftoj të gjithë kolegët ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Hasalla!

Atëherë, kjo është një marrëveshje ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila vjen në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe sipas relacionit të relatorit janë plotësuar kriteret nga komisioni ynë.

Kush nga kolegët e kërkon fjalën për pyetje? Nuk shikoj asnjë.

Në lidhje me thelbin e marrëveshjes foli zonja zëvendësministre.

Atëherë, kalojmë në votim.

Kolegë, ju lutem, ndizini kamerat, sepse sekretaria duhet të bëjë punë e saj që të kuptojë se si ngrihen duart për votim. Të gjithë janë me audio dhe video.

Sekretaria, ju lutem, le të numërojë votat.

Kush është dakord në parim me projektligjin? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim?  
Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së nivelit të lartë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për hartat treguese të rrjetit transeuropian të transportit në Shqipëri”.

Faleminderit, zonja Muçaj!

Jeni e lirë të shkoni dhe ju kërkohet ndjesë që ju lamë të prisnit.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 6.11.2023, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikat e zhvillimit””.

#### **Marrin pjesë:**

Klotilda Bushka, Jurgys Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Toni Gogu, Damian Gjikhuri, Gazmend Bardhi, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Lavdrim Krrashi, Eduard Ndreca, Elda Hoti, Dhurata Cupi, Greta Bardeli, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, dhe Arkend Balla.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Fatmir Mediu, Dhurata Cupi, Greta Bardeli, Bledion Nallbati, Saimir Korreshi, Fatmir Xhafaj Pandeli Majko, Erisa Xhixho, Dashnor Sula, Gledis Çeliku, Oerd Bylykbashi, Ermonela Felaj dhe Gerta Duraku.

#### **Të ftuar:**

Adela Xhemali – zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Kesjana Halili – drejtoreshë e Përgjithshme e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – drejtoreshë në Drejtorinë e Marrëveshjeve dhe Sigurimit të Ndihmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Klotilda Bushka** – Viojmë me pikën e fundit të rendit të ditës, me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikat e zhvillimit””.

Të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi zonjën Adela Xhemali, zëvendësministre, zonjën Kesjana Halili, drejtoreshë e Përgjithshme e Borxhit Publik, si dhe zonjën Elona Mistrovica, drejtoreshë në Drejtorinë e Marrëveshjeve dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj.

Presim vetëm një moment sa të bëhet lidhja me internet me zonjën Xhemali.

Kolegë, do të presim pak çaste pasi jemi në pikën e fundit të rendit të ditës, se edhe mbledhjet *online* kanë vështirësitë e tyre, kështu që duhet të jemi të gjithë pak më mirëkuptues.

Zonja Xhemali, zëvendësministrja, është duke u përpjekur të hyjë në linjë nga mjete i saj i komunikimit telefon, pasi nuk funksionon linja në kompjuterin e zyrës, kështu që kolegë shumë shpjet do të jetë pjesë e mbledhjes.

Zonja Xhemali, na dëgjoni?

**Adela Xhemali** – Unë ju dëgjoj, ju më dëgjoni mua?

**Klotilda Bushka** – Po.

Atëherë, zonja Xhemali fjala për ju për të bërë një prezantim shumë të shkurtër të këtij projektligji, ku konsiston ai dhe pse kërkon miratimin e tij. Më pas fjala do të jetë për zotin Denis Deliu, në cilësinë e relatorit.

Fjala për ju, zonja Xhemali.

**Adela Xhemali** – Faleminderit!

E nderuar kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë,

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër – hua për politikat e zhvillimit”, që do të mundësojë financimin e programit të mësipërm nëpërmjet akordimit të një huaje, në shumën 110,8 milionë euro.

Objektivi i këtij programi është të mbështesë përpjekjet e qeverisë për forcimin e qëndrueshmërisë së sektorëve, forcimin e kuadrit të tregut të energjisë, rritjen e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë, mbrojtjen e mjedisit, si dhe minimizimin e ndikimit të ndryshimeve klimaterike.

Konkretisht:

Shtylla e parë mbështet zgjerimin e bazës tatimore, forcimin e mekanizmave për zbutjen e rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore, përmirësimin e qëndrueshmërisë së investimeve publike nga ndryshimet klimaterike dhe rritjen e efektivitetit të programeve të ndihmës sociale.

Shtylla e dytë mbështet rritjen e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme dhe eficiencën e përdorimit të energjisë në sektorin publik.

Shtylla e tretë mbështet legjislacionin e ri për të minimizuar ndotjen e mjedisit, si dhe rregulloret për të vendosur një mekanizëm monitorimi, raportimi dhe verifikimi për gazrat serrë.

Programi përbëhet nga një seri prej dy kredish, për politika zhvillimi të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe që kanë në fokus rritjen e qëndrueshmërisë së ekonomisë dhe zhvillimin e gjelbër.

Projektligji është në përputhje me nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetues, si dhe nenit 17, të ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar në parim me VKM-në nr.390, datë 29.6.2023 dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Kjo kredi në formën e mbështetjes buxhetore është parashikuar në buxhetin e shtetit të vitit 2023 dhe termat janë terma të butë me një maturim prej 18 vjetësh, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 5-vjetësh dhe me një interes të përcaktueshëm bazuar në normën e referencës euribor + marzh të pandryshueshëm 1,17%. Natyrisht, kjo është një kredi me terma shumë të butë, krahasimisht me termat e tregut.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zonja Xhemali!

Fjala për zotin Deliu.

**Denis Deliu** – Përshëndetje!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuar zonja zëvendësministre,

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia

ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikën e zhvillimit”” është në përputhje me nenin 81, pika 1, si dhe me nenin 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, dhe vjen si propozim i Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, është në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër – hua për politikën e zhvillimit”, që do të mundësojë financimin e programit të mësipërm nëpërmjet akordimit të një huaje, në shumën 110 milionë e 8 mijë euro.

Kjo kredi është në formën e mbështetjes buxhetore. Pra, shkon për financimin e përgjithshëm të buxhetit të shtetit dhe deficitit të përgjithshëm të tij. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë si institucioni për ndjekjen dhe zbatimin e këtij ligji.

Në lidhje me efektet financiare në buxhetin e shtetit projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër, e nderuar kryetare, që të mos zgjatem, sepse zëvendësministrja e sqaroi me detaje projektligjin, unë kërkoj nga të gjithë kolegët ta miratojmë këtë marrëveshje.

Faleminderit!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Deliu!

Pra, jemi para ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare, që synon të përballojë pasojat e disa fatkeqësive natyrore, si: tërmeti, Covid-i, pasojat e inflacionit nga konflikti në Ukrainë dhe vjen në përputhje me Kushtetutën edhe ligjet e aplikueshme për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Komisioni përgjegjës do të duhet të ketë mendimin tonë para kalimit të këtij projektligji në shqyrtim dhe në miratim.

Atëherë, kolegë, a keni ndonjë pyetje apo ndonjë diskutim? Nuk keni.

Kolegët të dalin menjëherë me kamera që të vijojmë me procesin e votimit.

Në fakt, ne jemi 15 kolegë *online*, por vetëm 14 jemi para kamerave.

Atëherë, janë të gjithë *online* dhe sekretaria mund t'i shikojë që të bëjmë këqyrjen dhe vlerësimin e votimit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për



financimin e projektit “Aftësia ripërtëritëse e parë dhe zhvillimi i gjelbër - hua për politikën e zhvillimit””? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? 15 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji

Faleminderit, zonja Xhemali!

Faleminderit kolegë!

Për sot e kemi ezauruar rendin e ditës, ndërkohë që nesër dhe gjatë gjithë javës do të vijojmë me dëgjesat e institucioneve të pavarura, të atyre kushtetuese apo të krijuara me ligj në fushën e përgjegjësisë së komisionit tonë, në kuadër të shqyrtimit të ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”.

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**